

STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PAKT CONTRUKSION”

Ne Gjirokaster, sot me date 26-07-2021 , me vullnetin time te lire dhe bazuar ne ligjin 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare , une I nenshkruar :

- Hisen Tola I biri i Safetit , i datelindjes 15-05-1956 banues ne Gjirokaster , mbajtese e kartes se identitetit F60515035B

Vendosa :

NENI 1

Te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “PAKT CONSTRUKSION ” . Shoqeria eshte e formes “ Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar” SH.P.K.

NENI 2

Objekti I veprimtarise te shoqerise do te jete :
Tregtim me pakice dhe me shumice te materialeve te ndertimit. Prodhime llaci dhe bllloqe betoni



NENI 3

Afati I shoqerise :

- Shoqeria do ta ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe te pa caktuar kohore .
- Por ky afat mund te ndryshoje me vullnetin e lire te ortakeve.

NENI 4

Selia e shoqerise :

Gjirokaster , Cepo Mashkullore: Fshati Mashlullore, rruga nacionale Gjirokaster-Tepelene, godine nje kateshe , nr pasurie 253-13, ZK 2609

NENI 5

Kapitali I shoqerise :


- Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 100.000 leke (njeqin mije leke) .
- Kapitali I shoqerise do te zoterohet :
- Hisen Tola 100 % te kapitalit ose 1 kuote te barabarte me 100 000 leke
- Shoqeria mund ta zmadhoje ose ta zvogeloje kapitalin e saj .

NENI 6

Pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara nga ortaket jane te transmetueshme nepermjet :

- Nepermjet dhurimit
- Trashegimise
- Shitjes

Ortaket e shoqerise kane te drejten e parablerjes se kuotave te ofruara per shitje .



Çdo mos marreveshje ndermjet ortakeve zgjidhet nepermjet Gjykates .
Asambleja e ortakeve miraton transferimin e tyre .

NENI 7

Fitimi I realizuar nga veprimtaria e shoqerise u takon ortakeve te shoqerise ne raport me kontributin e e tyre ne krijimin e shoqerise .

Fitimi I deklaruar ne pasqyrat financiare mund te shperndahet vetem nese shoqeria ka likuide te mjaftueshme qe garantojne shlyerjen e detyrimeve .

Shoqeria mund te kerkoje kthimin e dividenteve te shperndare tek ortaket e saj ne rast se shperndarja eshte bere ne kundersizim me kete dispozite .

NENI 8

Administrimi :

- Organi me I larte I shoqerise eshte asambleja e pergjitheshme e ortakeve .
- Asambleja e ortakeve thirret nga ortaket ose administrator I shoqerise .
- Njoftimi per mbledhjen e asamblese se ortakeve behet me shkrese zyrtare dhe u dergohet ortakeve te pakten 10 dite perpara dates se mbledhjes .
- Administratori drejton mbledhjen e asamblese se ortakeve .
- Ortaket mund te perfaqesohet gjate mungeses se tyre nga nje ortak tjetër ose nje person I autorizuar .
- Autorizimi eshte I vlefshem vetem per nje mbledhje

Asambleja e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve si me poshte :



- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise .
- Ndryshimet e statutit te shoqerise I cili behet me **3/4** e kuotave te kapitalit te shoqerise .
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorit .
- Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel .
- Pregatitjes se pasqyrave financiare .
- Futjen e ortakeve te rinj ne shoqeri .
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
- Zmadhimin ose zvogelimin e aktivitetit te shoqerise .
- Riorganizimin , bashkimin , ndarjen apo prishjen e shoqerise .
- Krijimin ose mbylljen e filialeve te tjera te shoqerise .
- Vendimet e mbledhjes se asamblese se ortakeve pasqyrohen ne nje rregjister te vecante

NENI 9


Administratori :

- Administrator I shoqerise do te jete Andrea Puci mbajtes I id H71207020C .
- Afati administratorit do te jete 5 (pese) vjet .
- Afati I administratorit mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve .

NENI 10

Administratori I shoqerise ka kopetence dhe detyrohet te kryeje veprimet e percaktuara kryesisht ne nenin 95 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

Administrator mund te shkarkohet me vendim te asamblese se ortakeve



Administratoret permbushin detyrimet qe u lindin nga neni 98 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

NENI 11

Per arritjen e qellimeve te veta shoqeria mund te punesoje punonjes te tjere te ndryshem , duke respektuar legjislacionin ne fuqi .

NENI 12

Ortaku mund te perjashtohet nga shoqeria me vendim te gjykates per arsyet e permendura ne nenin 102 te ligjit 9901 date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

Shoqeria rezervon te drejten per te kerkuar shperblimin e demit te ardhuar nga veprimet e ortakut qe cuan ne perjashtimin e tij .

NENI 13

Shoqeria priset :

- Ne perfundim te afatit .
- Eshte vendosur me unanimitet nga assembleja e pergjitheshme e ortakeve
- Me hapjen e procedurave te likujdimit .
- Me vendim te Gjykates



NENI 14

Fitimi qe do te rezultoje nga veprimtaria e shoqerise I takon ortakeve te saj . shoqeria nuk pergjigjet per humbjen e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise . Mosmarreshjet qe mund te lindin mes paleve brenda dhe jashte shoqerise , me persona fizike e juridike zgjidhen nga Gjykata Kopetente Shqiptare

ORTAKU THEMELUES

Husein Toleq
